



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat Afatshkurtëra të Industrisë

TM3 2016



Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave afatshkurtra të Ndërmarrjeve *industriale* për periudhën TM3 - 2016 (2012=100).

Nga tremujori i parë i 2012, e këndeje ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK-së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve. Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon të paraqet ecurinë në industri (*B - nxjerrëse, C - përpunuese, D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe E - Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimin të mbeturinave*) në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit në industri.

Rezultatet e këtij hulumtimi në të njëjtën kohë përdoren për nevoja të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit në baza tremujore.

.

Publikimi është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit

Ismajl Sahiti - Shef i Divizionit

Hysni Elshani - Shef i sektorit të statistikave ekonomike

Valdete Navakazi - Zyrtare

Luljeta Krasniqi - Zyrtare

Muhamet Kastrati - Menaxher i bazës së të dhënave të RSB

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën elektronike:

(E-mail: economic@rks-gov.net)

Dhjetor, 2016

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Simbolet dhe shkurtesat

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NVE	-	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
RSB	-	Regjistri Statistikorë i Bizneseve
SAN	-	Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

TM1	-	Tremujori i parë
TM2	-	Tremujori i dytë
TM3	-	Tremujori i tretë
TM4	-	Tremujori i katërt

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
n/a	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

Faqe

1	Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.1.	Objektivi.....	4
1.2.	Metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.3.	Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës	5
1.4.	Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave	5
2	Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë.....	6
2.1.	Definicione dhe përkufizime	6
2.2.	Treguesit themelorë.....	6
3	Industria.....	7
3.1.	Struktura e qarkullimit nga aktivitetet Industriale (B,C, D dhe E)	7
3.2.	Numri i të të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E).....	7
4	Indeksi i qarkullimit dhe numrit të të punësuarve nga aktivitetet industriale (B,C,D dhe E).....	8
4.1.	Indeksi i qarkullimit industrial.....	8
4.2.	Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial.....	10

1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivi

Objektivi kryesor i Anketës së Statistikave afatshkurtëra të ndërmarrjeve industriale është paraqitja e trendëve nëpër periudha tremujore në sektorët (B, C, D dhe E) të Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NACE Rev.2, nëpërmjet disa treguesve ekonomik , që mundëson krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat tremujore. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetet e industrisë (B, C, D dhe E), në të gjithë territorin e vendit.

1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Statistikat afatshkurtëra të ndërmarrjeve për tremujorin e tretë 2016 janë të publikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2).

Anketa mbulon në mënyrë të përmbledhur aktivitetin e Industrisë.

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është sipas rregullave dhe rekomandimeve të EUROSTAT-it. Pyetësi është përpiluar në bashkëpunim me Ekspert Suedez dhe është rishikuar nga Ekspert të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Duke filluar nga tremujor i parë (TM1 - 2016), kemi bërë modifikimin e pyetësit dhe mostrës me qëllim të përafrimit me kërkesat dhe rekomandimet e EUROSTAT-it për Statistikat afatshkurtëra të Industrisë. Pas krijimit të serisë kohore do të bëhet edhe publikimi i rezultateve të të dhënave në TM1-2017.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë të dhënat për aktivitetet ekonomike si:

B - Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)

C - Industria përpunuese

D - Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar

E - Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave.

1.3. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev2. Numri i ndërmarrjeve të përfshira në anketë është 326 ndërmarrje që mirren me prodhimtari industriale.

1.4. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave

Mbledhja e të dhënave është kryer kryesisht përmes :

- metodës së intervistimit të drejtpërdrejt nga anketuesit e ASK-së.
- metodës së dërgimit të pyetësorit në mënyrë elektronike.
- metodës së lënies së pyetësorit për plotësim tek biznesi.

Anketa në teren del 20 ditë pas përfundimit të tremujorit dhe afati për grumbullimin e të dhënave nga terreni është 40 ditë pas daljes në terren.

2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

2.1. Definicione dhe përkufizime

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

Vlera e qarkullimit nga prodhimi - paraqet qarkullimin e realizuar nga prodhimi duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variable të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

Indeksi i vlerës së qarkullimit nga prodhimi - Objektiv i indeksit të vlerës së qarkullimit është të paraqesë ecurinë e tregut.

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.

2.2. Treguesit themelorë

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vitin referues bazë, aktualisht 2012=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Matet ndryshimi në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi - Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficientëve të përdorur , etj.

3 Industria

3.1. Struktura e qarkullimit nga aktivitetet Industriale (B,C, D dhe E)

Tremujori i tretë 2016 - Tremujorin e dytë 2016

Në tremujorin e tretë të vitit 2016 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2016, Industria përpunuese (C) ka pasur një rritje prej 3.0 % , *derisa rënie kishte në sektorin Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me (20.3 %) ,Industria Nxjerrëse (B) me (4.7 %),si dhe Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) prej (2.2 %).*

Tremujori i tretë 2016 - Tremujorin e tretë 2015

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM 3 2015), ka pasur një rritje sektori *Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) me 14.1%*, Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me 4.8%, *ndërsa sektori Industria përpunuese (C) kishte rënie prej (13.9 %) si dhe Industria Nxjerrëse (B) me (3.3 %).*

3.2.Numri i të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E)

Tremujori i tretë 2016 - Tremujorin e dytë 2016

Numri i të punësuarve në tremujorin e tretë të vitit 2016 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2016 është rritur në sektorin *Industria përpunuese (C) me 2.5 %* si dhe Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) me 0.6 % , *ndërsa rënie kishte tek sektori Industria Nxjerrëse (B) me (1.9 %) dhe në sektorin Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me (0.8 %).*

Tremujori i tretë 2016 - Tremujorin e tretë 2015

Në raport me tremujorin e tretë të vitit 2015, në tremujorin e tretë të vitit 2016 kishte rritje të numrit të punësuarve në sektorin *Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) për 1.6 %*, *ndërsa kishte rënie tek sektori Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me (2.8 %) Industria Nxjerrëse (B) me (2.0 %)*, *si dhe Industria përpunuese (C) me (1.2 %).*

4 Indeksi i qarkullimit dhe numrit të të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B,C,D dhe E)

4.1. Indeksi i qarkullimit industrial


Tab 1. Indeksi i qarkullimit industrial (2012=100)

Sektori	Nve Rev.2	Aktiviteti ekonomik	2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2	2015 TM3	2015 TM4	2016 TM1	2016 TM2	2016 TM3
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	93.6	104.4	102.4	176.9	81.3	85.3	132.4	138.2	45.8	88.6	99.4	143.0	76.0	100.9	96.2
C	10-33	Industri përpunuese	77.3	105.5	114.9	94.6	81.3	102.0	115.4	122.1	87.9	115.3	127.7	105.5	83.7	106.7	109.9
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	131.0	120.6	109.5	112.9	116.4	87.1	59.4	97.6	111.3	95.3	86.7	116.1	120.1	113.9	90.8
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	93.5	102.5	97.4	96.7	96.6	98.6	91.5	83.1	89.3	89.2	79.4	75.0	87.0	92.6	90.6

*Në sektorin D nuk është e përfshirë edhe shpërndarja e energjisë elektrike.

**Nga tremujori i dytë 2015 deri në tremujorin e katërt 2015 është bërë korigjimi i të dhënave.

Figura 1. Indeksi i qarkullimit nga prodhimi sipas aktiviteteve B,C, D dhe E (2012=100)



Tab 1a. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak

Sektori	Nve Rev.2	Aktiviteti ekonomik															%
			2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2	2015 TM3	2015 TM4	2016 TM1	2016 TM2	2016 TM3
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	-20.8	11.6	-1.9	72.8	-54.1	5.0	55.2	4.4	-66.9	93.6	12.2	43.9	-46.9	32.8	-4.7
C	10-33	Industri përpunuese	-30.8	36.6	8.9	-17.7	-14.1	25.5	13.1	5.9	-28.0	31.2	10.7	-17.4	-20.7	27.4	3.0
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	6.4	-7.9	-9.2	3.0	3.2	-25.2	-31.8	64.4	14.0	-14.4	-9.1	33.9	3.5	-5.1	-20.3
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	-3.8	9.6	-5.0	-0.7	-0.2	2.1	-7.2	-9.2	7.5	-0.1	-11.0	-5.5	16.0	6.5	-2.2

Tab 1b. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak


Sektori	Nve Rev.2	Aktiviteti ekonomik															%
			2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2	2015 TM3	2015 TM4	2016 TM1	2016 TM2	2016 TM3
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	40.8	25.1	-22.4	49.8	-13.2	-18.3	29.3	-21.9	-43.7	3.9	-24.9	3.5	66.0	13.9	-3.3
C	10-33	Industri përpunuese	2.1	3.0	4.2	-15.3	5.2	-3.4	0.4	29.1	8.2	13.1	10.7	-13.6	-4.8	-7.5	-13.9
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	9.9	51.1	40.7	-8.3	-11.1	-27.8	-45.8	-13.5	-4.4	9.5	45.9	18.9	7.9	19.5	4.8
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	0.9	-3.6	-6.1	-0.5	3.3	-3.8	-6.1	-14.1	-7.5	-9.5	-13.2	-9.7	-2.6	3.8	14.1

4.2. Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial

Tab 2. Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial (2012=100)

Spektori	Nive Rev.2	Aktiviteti ekonomik	2013 TM1	2013 TM2	2013 TM3	2013 TM4	2014 TM1	2014 TM2	2014 TM3	2014 TM4	2015 TM1	2015 TM2	2015 TM3	2015 TM4	2016 TM1	2016 TM2	2016 TM3
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	98.9	99.7	101.1	101.0	98.4	100.3	99.5	98.7	98.1	98.3	98.2	99.1	97.4	98.1	96.2
C	10-33	Industri përpunuese	92.8	98.6	98.8	98.9	88.5	95.6	90.1	85.7	75.6	79.4	82.7	82.2	80.3	79.7	81.7
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	104.2	104.2	104.1	104.1	95.7	91.5	90.6	89.7	89.3	89.3	87.4	85.2	86.5	85.7	85.0
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimin të mbeturinave	106.3	106.5	107.3	108.5	108.8	111.1	111.3	111.9	114.6	115.6	115.5	114.2	112.8	116.7	117.4

Figura 2. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve B, C, D dhe E (2012=100)



Tab 2a. Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak

Sektori	Nve Rev.2	Aktiviteti ekonomik	%															
			2013 TM1 2012 TM4	2013 TM2 2013 TM1	2013 TM3 2013 TM2	2013 TM4 2013 TM3	2014 TM1 2013 TM4	2014 TM2 2014 TM1	2014 TM3 2014 TM2	2014 TM4 2014 TM3	2015 TM1 2014 TM4	2015 TM2 2015 TM1	2015 TM3 2015 TM2	2015 TM4 2015 TM3	2016 TM1 2015 TM4	2016 TM2 2016 TM1	2016 TM3 2016 TM2	
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	-1.8	0.9	1.3	0.0	-2.6	1.9	-0.9	-0.8	-0.6	0.2	-0.1	1.0	-1.7	0.6	-1.9	
C	10-33	Industri përpunuese	-7.6	6.2	0.3	0.1	-10.5	8.1	-5.8	-4.8	-11.8	5.0	4.1	-0.5	-2.4	-0.8	2.5	
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	4.2	0.0	-0.1	0.0	-8.1	-4.4	-1.0	-1.0	-0.4	0.0	-2.1	-2.6	1.6	-1.0	-0.8	
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	0.2	0.3	0.7	1.1	0.3	2.1	0.1	0.6	2.4	0.8	0.0	-1.2	-1.2	3.4	0.6	

Tab 2b. Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak

Sektori	Nve Rev.2	Aktiviteti ekonomik	%															
			2013 TM1 2012 TM1	2013 TM2 2012 TM2	2013 TM3 2012 TM3	2013 TM4 2012 TM4	2014 TM1 2013 TM1	2014 TM2 2013 TM2	2014 TM3 2013 TM3	2014 TM4 2013 TM4	2015 TM1 2014 TM1	2015 TM2 2014 TM2	2015 TM3 2014 TM3	2015 TM4 2014 TM4	2016 TM1 2015 TM1	2016 TM2 2015 TM2	2016 TM3 2015 TM3	
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	0.0	-0.3	0.6	0.4	-0.5	0.6	-1.6	-2.4	-0.3	-2.0	-1.3	0.5	-0.7	-0.3	-2.0	
C	10-33	Industri përpunuese	-3.6	-2.1	-3.7	-1.6	-4.7	-3.0	-8.8	-13.3	-14.5	-16.9	-8.2	-4.1	6.2	0.3	-1.2	
D	35	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	4.1	4.1	4.2	4.1	-8.1	-12.2	-13.0	-13.8	-6.7	-2.4	-3.5	-5.0	-3.1	-4.0	-2.8	
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	14.9	10.4	2.2	2.3	2.4	4.3	3.7	3.2	5.3	4.0	3.8	2.0	-1.6	0.9	1.6	

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësie raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
 - **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
 - **Fax::** +381 (0) 38 235 033
 - **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>